



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 94, Datë 06.04.2021

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 41, DATË 06.03.2020 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGJI” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET: “BACKA 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1600 kW, HEC “BACKA 2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 4000 kW, HEC “BACKA A” ME KAPACITET TË INSTALUAR 500 kW, HEC “BACKA B”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 500 kW, HEC “BACKA C” ME KAPACITET TË INSTALUAR 720 kW, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 7320 kW.**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, në mbledhjen e tij të datës 06.04.2021, Bordi i ERE pasi shqyrtoi relacionin nr. 40/6 prot, datë 02.04.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 41, datë 06.03.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Backa 1”; me kapacitet të instaluar 1600 kW; “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kW, “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kW; “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kW dhe “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kW, me kapacitet total 7320 kW,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 41, datë 06.03.2020, vendosi:

*1. Të licencojë shoqërinë “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Backa 1”; me kapacitet të instaluar 1600 kW; “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kW, “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kW; “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kW dhe “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kW, me kapacitet total 7320 kW, për një afat 28 vjet e 5 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë, shoqëria të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor.*

*2. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.*

- Në plotësim të kushtit të sipërcituar, shoqëria “KROI MBRET ENERGGJI” sh.p.k., me shkresën nr. 422 prot., datë 31.03.2021, protokolluar në ERE me nr. 467/2 prot., datë 31.03.2021, në përmbushje të kushtit të vendimit të sipërcituar ka përcjellë lejet si vijon:
  - Lejen nr. 184, datë 22.03.2021, miratuar me vendimin nr. 3, datë 12.03.2021 të Këshillit të Basenit Ujor Seman, “Për përdorim burimi ujor sipërfaqësor” dhënë shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për HEC Backa A, me prurje mesatare vjetore 87 l/s, me vendndodhje në Bashkinë Skrapar, për prodhim hidroenergjie, me afat sipas kontratës së koncesionit.
  - Lejen nr. 186, datë 22.03.2021, miratuar me vendimin nr. 4, datë 12.03.2021 të Këshillit të Basenit Ujor Seman, “Për përdorim burimi ujor sipërfaqësor” dhënë shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për HEC Backa C, me prurje mesatare vjetore 478 l/s, me vendndodhje në Bashkinë Skrapar, për prodhim hidroenergjie, me afat sipas kontratës së koncesionit.
  - Lejen nr. 186, datë 22.03.2021, miratuar me vendimin nr. 5, datë 12.03.2021 të Këshillit të Basenit Ujor Seman, “Për përdorim burimi ujor sipërfaqësor” dhënë shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për HEC Backa 1, me prurje mesatare vjetore 820 l/s, me vendndodhje në Bashkinë Skrapar, për prodhim hidroenergjie, me afat sipas kontratës së koncesionit.
- Sa më sipër shoqëria “KROI MBRET ENERGGJI” sh.p.k., ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 41, datë 06.03.2020 “Mbi licencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Backa 1”; me kapacitet të instaluar 1600 kW; “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kW, “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kW; “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kW dhe “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kW, me kapacitet total 7320 kW”.
- Me plotësimin e kushtit nga ana e shoqërisë, nuk ka më asnjë dokument që ka të dhëna se duhet t’i nënshtrohet procedurës së rinovimit. Kjo referuar edhe konstatimeve të vendimit përkatës të licencimit nr. 41/2020. Për rrjedhojë, aktualisht shoqëria rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.
- Në nenin 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

### Vendosi:

1. Pika 1 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 41, datë 06.03.2020 ndryshon si vijon:

#### **Ishte:**

1. Të licencojë shoqërinë “KROI MBRET ENERGGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Backa 1”; me kapacitet të instaluar 1600 kW; “Backa 2”

*me kapacitet të instaluar 4000 kW, “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kW; “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kW dhe “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kW, me kapacitet total 7320 kW, për një afat 28 vjet e 5 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë, shoqëria të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor.*

**Bëhet:**

- 1. Të licencojë shoqërinë “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Backa 1”; me kapacitet të instaluar 1600 kW; “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kW, “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kW; “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kW dhe “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kW, me kapacitet total 7320 kW, për një afat 28 vjet e 5 muaj.*
2. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 41, datë 06.03.2020, shfuqizohet.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë subjektin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**